

VENDIM
Nr.742, datë 6.11.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.692, DATË 13.12.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MASAT E VEÇANTA TË SIGURIMIT DHE TË MBROJTJES SË SHËNDETIT NË PUNË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 40 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.692, datë 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1, 2/2, 2/3 dhe 2/4 me këtë përmbajtje:

"2/1. Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike.

2/2. Mjekët e ndërmarrjes pajisen me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me vendimin nr.500, datë 23.11.1992 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e licencave për ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë, në profesion të lirë privat", i ndryshuar.

2/3. Mjekët e ndërmarrjes merren në punë si nëpunës të ndërmarrjes dhe varen drejtpërdrejt nga punëdhënësi. Punëdhënësi e njëj mjekun me detyrat e shërbimit shëndetësor të ndërmarrjes dhe kërkon zbatimin e tyre, sipas legjislacionit të punës. Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësit dhe mjekut të ndërmarrjes përcaktohen në bazë të kontratës së punës që lidhin palët, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2/4. Mjeku i ndërmarrjes ka këto detyra:

a) Këshillon punëdhënësin për problemet e mbrojtjes në punë, për shmangien e aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale, si dhe për të gjitha çështjet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;

b) vlerëson çështje të fiziologjisë së punës, të problemeve higjienike e sanitare, veçanërisht të ritmit e të kohës së punës, të organizimit të vendit të punës, të zhvillimit dhe të mjediseve të punës;

c) rekomandon çështje të ndryshimit të vendeve të punës për riintegrimin e të gjymtuarve në procesin e punës dhe të të sëmurëve me sëmundje profesionale, si dhe studion shkaqet e aksidenteve në punë e të sëmundjeve profesionale, duke i propozuar punëmarrësit masat për shmangien e tyre;

ç) kontrollon pranimin në punë të punëmarrësve, në përputhje me raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni medikoligjor, në bazë të aftësive shëndetësore për procesin konkret të punës, si dhe organizon ekzaminimin periodik, shëndetësor, për të gjithë punonjësit, një herë në 6 muaj;

d) ndjek, në mënyrë të vazhdueshme, të sëmurët kronikë, bën konsulta me mjekët e familjes dhe specialistët, si dhe ndërhyr te punëdhënësi, që, në rast nevojë, të bëjë ndërrimin e vendit të punës;

dh) bashkëpunon me mjekun e sëmundjeve profesionale dhe repartet klinike të sëmundjeve profesionale, për diagnozën dhe trajtimin e të sëmurëve me sëmundje profesionale;

e) plotëson regjistrin e paaftësisë së përkohshme në punë, të aksidentit në punë dhe sëmundjeve profesionale, si dhe, në bashkëpunim me punëdhënësin, denoncon pranë Inspektoratit të Punës rastet e aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale."

2. Pikat 9 dhe 10 shfuqizohen.

3. Pas pikës 12 shtohen pikat 12/1, 12/2 dhe 12/3 me këtë përmbajtje:

"12/1. Marrja në punë e mjekut është e detyrueshme për të gjitha subjektet, veprimtaria e të cilave klasifikohet sipas vendimeve nr.459, datë 22.7.1998 "Për substancat e rrezikshme",

nr.419, datë 4.8.2000 "Për objektet e rrezikshme" dhe nr.207, datë 9.5.2002 "Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme" të Këshillit të Ministrave, pavarësisht nga numri i të punësuarve.

12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.

12/3. Mjeku i ndërmarrjes mban përgjegjësi sipas ligjit për pasojat, që mund të vijnë nga moszbatimi i detyrave të përcaktuara sipas pikës 2/4 të këtij vendimi."

4. Pas pikës 13 shtohen pikat 14 dhe 15 me këtë përmbajtje:

"14.Vendimi nr.449, datë 17.10.1992 i Këshillit të Ministrave "Për riorganizimin e shërbimit mjekësor në ndërmarrje", shfuqizohet.

15. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano